

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-23-0095*****Në ankesën e******Paditësi/Ankuesi*****Rr B**, të cilën e përfaqëson përmes avokatit B I, Prishtinë.***kundër******E paditura*****NSH, "Magjistratja"**, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Agron Hoxhaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me parashtrësën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-22-0012 të datës 03 shkurt 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 janar 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Parashtrësja e paditësit e datës 21 shkurt 2023 e paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-22-0012 të datës 03 shkurt 2023, hedhet poshtë si e pa pranueshme.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 10 korrik 2013, përmes postës paditësi, ish punëtor i NSH-së "Magjistranja" në Prishtinë e ka dorëzuar një ankesë të përbashkët me ankuesit tjerë, që të gjithë të përfaqësuar nga avokati B I, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Magjistranja" në Prishtinë PRN032-0041 të datës 31 maj 2013 me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensim e pagave të papaguara për periudhën janar 2006-dhjetor 2007, në shumën totale prej 6.711,84 euro nga NSH- "Magjistranja" në Prishtinë. Kjo ankesë e përbashkët në bazë të urdhrit të gjykatës është ndarë, andaj avokati i paditëses me datë 30 shtator 2015, e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe bënë ndarjen dhe plotësimin e ankesës, e cila regjistrohet me numrin C-IV-15-1804. Paditësi në ankesë pohon se në NSH "Magjistranja" në Prishtinë ishte në marrëdhënie të përhershme pune dhe kishte dokumentacion të mjaftueshëm, që atij t'i paguhen pagat e pa paguara deri në ditën e privatizimit të NSH-së.

Me datë 21 korrik 2020, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit që ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit duke i përmbushur përgjegjësitë e veta ligjore, ka kërkuar së pari prej paditësit e pastaj edhe prej burimeve të tjera, prova për përcaktimin e të drejtës në kompensimin e pagave të pa paguara, ndërsa Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se një grup i ish punëtorëve të NSH-së kanë kryer punë të caktuara për të cilat janë paguar, ndërsa paditësi nuk ka qenë në listën e pagave, andaj ai nuk ka punuar në NSH-ë. Tutje AKP-ja pohon se do të ishte padrejtësi që të paguhen ish punëtorët me grupin e punëtorëve që kanë punuar në NSH. AKP-ja po ashtu pohon se paditësi kishte për detyrë ta provojë me prova kërkesën e tij. Mirëpo Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se dokumentacioni i ofruar nuk ishte i plotë, andaj ka vendosur ta refuzojë kërkesën. Bashkë me mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka dorëzuar vendimin e ankimit të Autoritetit të Likuidimit dhe fletë kthesën e pranimi të vendimit.

Me datë 10 dhjetor 2020, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1804 e refuzoi ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nuk ishte kontestues fakti se paditësi ishte punëtorë i NSH-së "Magjistranja" në likuidim, mirëpo paditësi nuk kishte punuar në punët dhe detyrat e tij të punës, prandaj nuk janë njohur pagat e pretenduara për periudhën janar 2006-prill 2007. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se listat e pagave të dorëzuara nga paditësi si provë, të nënshkruara nga llogaritari dhe personi tjetër i pa identifikuar janë vlerësuar si të pa pranueshme, për faktin se nuk janë aprovuar nga AKP-ja apo ish AKM-ja, nën menaxhimin e të cilave ka qenë kur ka filluar procedura e likuidimit. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se Lista e punëtorëve për 20% e ofruar nga paditësi nuk shërben si bazë juridike për të kërkuar pagat për periudhën e cekur. Shkalla e I-rë po ashtu konstaton se barra e provës në kuptimin e nenit 322.1 të LPK-së, bie mbi paditësin dhe ai nuk ka provuar me ndonjë provë materiale të ketë punuar në NSH-ë nga janari 2006 e deri në prill të vitit 2007, pavarësisht faktit se të njëjtit formalisht nuk i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës.

Me datë 25 janar 2021, paditësi e dorëzoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-1804, të datës 10 dhjetor 2020, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit dhe të aprovohet padia si e bazuar duke e detyruar të paditurën që të paguaj borxhin në shumë prej 6.711,84 euro, interesin ligjorë në shumë prej 1.476,60 euro dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 416,00 euro. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se konstatimet e Shkallës së I-rë të dhëna në Aktgjykimin e ankimuar janë të gabuara dhe jo të drejta. Listat e pagave të papaguara janë përpiluar, protokolluar nënshkruar dhe vulosur për punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore të cilat nuk janë miratuar nga AKM-ë AKP-ë, por nga menaxhmenti i NSH-së. Tutje paditësi pohon se as punëtori e aq më pak përfaqësuesi me prokurë, AKP-ja apo gjykatësi ka mbajtur evidencë të punës për secilin punëtorë, se sa orë ka punuar dhe cilat punë i ka kryer, andaj Aktgjykimi

është i pa bazë dhe mbështetet në argumente të paqëndrueshme pa pasur asnjë provë. Padiësi pohon se ai ka argumentuar me prova të mjaftuara kërkesën e tij ndërsa listat e pagave për periudhën janar 2005 prill 2007, padiësin e kanë radhitur në nr.32 dhe për periudhën janar 2006-prill 2007 NSH-ja i ka mbetur borxh në shumë prej 6.711,84 euro. Prandaj është e habitshme pse gjykata këtë dokument nuk e ka vlerësuar si provë valide, edhe pse Listat janë nënshkruar nga personat e autorizuar të NSH-së. Tutje ai pohon se në ankesën në Shkallën e I-rë i ka propozuar gjykatës që të mbajë seancë dhe të dëgjohen si dëshmitarë drejtori Sh P, kontabilistët A K, G H dhe A B, nëse këto prova që i kishte sjellë në gjykatë nuk do të ishin të mjaftueshme për gjykatën. Bashkë me ankesë ai ka dërguar Njoftimin e AKM-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 22 maj 2007, Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe Listat e pagave të punëtorëve për periudhën e cekur.

Me datë 22 shkurt 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së padiësit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se argumentet e saj lidhur me ankesën i ka parashtruar në mbrojtje në ankesë, andaj nuk do të përsëriten më ngase kjo nuk do të ishte e dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 02 shtator 2021, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-20-0061 e aprovon ankesën si të bazuar, e anulon Aktgjykimi e ankimuar dhe lëndën e kthen në rishqyrtim tek gjyqtari përkatës. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se nuk e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së dhe as të Autoritetit të Likuidimit, që ka bazë të mjaftueshme për ta refuzuar kërkesën e padiësit për pagat e pretenduara ndaj NSH-së, por gjithashtu nuk e mbështet as pretendimin e padiësit se me provat që ai i ka ofruar deri më tani, janë bazë e mjaftueshme për t'ia njohur të drejtën në paga për periudhën e cekur. Kolegji i Apelit i ka shqyrtuar të gjitha provat që i kishte ofruar padiësi në gjykatë dhe konstaton me sa vijon: është e vërtetë që Listat e pagave të papaguara të ofruara nga padiësi vetëm në procedurën ankimore janë të nënshkruara, mirëpo këto Lista nuk janë të protokolluara dhe as të vërtetuara me vulë të NSH-së. Kolegji i Apelit vëren se në

fundin e çdo liste shënohen emërtimet "Llogaritari", "Likuidatori" dhe "Vërteton". Tek emërtimi i cekur "Llogaritari" ka një nënshkrim, por nuk ceket emri dhe mbiemri i zyrtarit përgjegjës të NSH-së, ndërsa tek emërtimi "Likuidatori" nuk ka fare nënshkrim, e po ashtu tek emërtimi "Vërteton", ka një nënshkrim të një personi, por nuk ka emër dhe mbiemër të personit që ka nënshkruar, dhe nuk ka mundësi të identifikohet saktë cili person zyrtarë i NSH-së i ka vërtetuar këto Lista të pagave të papaguara, dhe nëse ky nënshkrim i dhënë tek emërtimi "Vërteton" është i drejtorit të NSH-së. Këto të meta të cilat u cekën më lartë e bëjnë që këto prova deri në këtë fazë të procedurës të mos konsiderohen prova valide e bindëse për gjykatën, për të njohur paditësit të drejtën e pretenduar për paga. Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e Shkallës së I-rë ka kërkuar që të mbahet seancë dëgjimore dhe të dëgjohen si dëshmitarë drejtori i NSH-së dhe persona të tjerë të cekur në këtë ankesë, nëse gjykata do të vlerësonte se provat e ofruara nga ai nuk janë të mjaftueshme për ta aprovuar kërkesën për këto paga. Kjo kërkesë e paditësit nuk është përfillur nga Shkalla e I-rë, dhe nuk është mbajtur seancë dëgjimore. Kolegji i Apelit po ashtu vëren se edhe AKP-ja në mbrojtjen në ankesë dhe në kundërpërgjigje i ka kundërshtuar pretendimet e paditësit për borxhin e pretenduar ndaj NSH-së, duke pohuar se nuk ka asnjë provë, që paditësi në periudhën e cekur ka punuar për NSH-në. Paditësi vetëm në procedurën ankimore e ka sjellë Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe fotokopjen e Librezës së punës dhe këto dëshmi vërtetojnë që paditësit formalisht marrëdhënia e punës i është ndërprerë me datë 22 maj 2007, mirëpo këto prova ende nuk janë dëshmi e mjaftueshme që të aprovohet padia si e bazuar, pasi që paditësi nuk ka sjellë prova të tjera të nevojshme për të dëshmuar se ai në fakt ka punuar në NSH në periudhën nga janari 2006 e deri në prill 2007, ndërsa Listat e pagave të ofruara nga paditësi siç u tha më sipër kanë të meta dhe ende nuk janë prova bindëse për gjykatën.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim, ajo ka marrë numrin e ri, C-IV-21-0149.

Me datë 15 shtator 2021, shkalla e I-rë e DHPGJS lëshon një Urdhër për paditësin dhe për AKP-në dhe kërkon nga të dy palët që të dorëzojnë të gjitha provat që

nuk janë në shkresat e lëndës lidhur me pretendimet e palës paditëse, duke paralajmëruar që nëse nuk sjellin prova të reja do të vendos në bazë të provave që i ka në dispozicion.

Me datë 07 tetor 2021, AKP-ja e dorëzon një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Në këtë parashtresë AKP-ja ka pohuar se në bazë të rregullit bazik nga neni 7 i LPK-së barra për të sjellë prova i bie paditësit, mirëpo ajo thotë se ka bërë hulumtime në arkivin e NSH-së, dhe lidhur me kërkesën e paditësit ka gjetur padinë, mbrojtjen, kërkesën për informacion shtesë dhe Vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Me këtë parashtresë AKP-ja i sjellë kopjet e dokumenteve të cilave u referohet.

Me datë 07 tetor 2021, paditësi e dorëzon një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Në këtë parashtresë paditësi pohon se provat që i kishte i ka dorëzuar në gjykatë para se lënda të kthehet në rigjykim, duke pohuar se është dorëzuar Letër pezullimi i datës 22 maj 2007, formulari i kërkesës, kopja e Librezës së punës, Lista e pagave të hartuara nga Kontabilisti i njësisë së Magjistrales në Prizren të nënshkruara nga personat e autorizuar për periudhën 2005-2007 dhe Vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Lidhur me provat tjera të kërkuara, besoj se është e kuptueshme se punëtorët nuk arrijnë as ti ruajnë dokumentacionin e viteve 2006 dhe 2007 dhe se ky dokumentacion ruhet nga AKP-ja për NSH-në që është në likuidim. Me këtë parashtresë i dërgon dokumentet të cilave u referohet.

Me datë 15 dhjetor 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-21-0149 e refuzon ankesën si të pa bazuar dhe e vërteton Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në Ligj. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se nuk ishte kontestues fakti se paditësi ishte punëtorë i NSH-së "Magjistrallja" në likuidim, mirëpo paditësi nuk kishte punuar në punët dhe detyrat e tij të punës, prandaj nuk janë njohur pagat e pretenduara për periudhën janar 2006-prill 2007. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se listat e pagave të dorëzuara nga paditësi si provë, të nënshkruara nga llogaritari dhe personi tjetër i pa identifikuar janë vlerësuar si të pa pranueshme, për faktin se nuk janë aprovuar nga AKP-ja

apo ish AKM-ja, nën menaxhimin e të cilave ka qenë kur ka filluar procedura e likuidimit. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se Lista e punëtorëve për 20% e ofruar nga paditësi nuk shërben si bazë juridike për të kërkuar pagat për periudhën e cekur. Shkalla e I-rë po ashtu konstaton se barra e provës në kuptimin e nenit 322.1 të LPK-së, bie mbi paditësin dhe ai nuk ka provuar me ndonjë provë materiale të ketë punuar në NSH nga janari 2006 e deri në prill të vitit 2007, pavarësisht faktit se të njëjtit formalisht nuk i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës.

Me datë 05 janar 2022, paditësi për mes postës e dorëzoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-21-0149, të datës 15 dhjetor 2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit dhe të aprovohet padia si e bazuar duke e detyruar të paditurën që të paguaj borxhin në shumë prej 6.711,84 euro, interesin ligjorë në shumë prej 1.476,60 euro dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 416,00 euro. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se në procedurën në shkallën e I-rë nuk ka marrë mbrojtje e AKP-së dhe kjo paraqet shkelje të nenit 38 të LDHP-së. Ajo pohon se nuk ka qenë në dijeni se çfarë ka deklaruar e paditura me shkrim lidhur me padinë/ankesën. Tutje paditësi pohon se konstatimet e Shkallës së I-rë të dhëna në Aktgjykimin e ankimuar janë të gabuara dhe jo të drejta dhe nuk i ka përmend dhe dhënë vlerësime për provat e dorëzuara. Listat e pagave të papaguara janë përpiluar, protokolluar nënshkruar dhe vulosur për punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore të cilat nuk janë miratuar nga AKM-ë AKP-ë, por nga menaxhmenti i NSH-së. Tutje paditësi pohon se as punëtori e aq më pak përfaqësuesi me prokurë, AKP-ja apo gjykatësi ka mbajtur evidencë të punës për secilin punëtorë, se sa orë ka punuar dhe cilat punë i ka kryer, andaj Aktgjykimi është i pa bazë dhe mbështetet në argumente të paqëndrueshme pa pasur asnjë provë. Paditësi pohon se ai ka argumentuar me prova të mjaftuara kërkesën e tij ndërsa listat e pagave për periudhën janar 2005 prill 2007, paditësin e kanë radhitur në nr.32 dhe për periudhën janar 2006-prill 2007 NSH-ja i ka mbetur borxh në shumë prej 6.711,84 euro. Prandaj është e

habitshme pse gjykata këtë dokument nuk e ka vlerësuar si provë valide, edhe pse Listat janë nënshkruar nga personat e autorizuar të NSH-së. Tutje ai pohon paditësi e kishte pranuar Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 22 maj 2007, dhe me këtë Njoftim AKP-ja i merre dhe i pranon obligimet monetare ndaj Ankuesit, të cilat obligime do të trajtohen në procedurën e likuidimit. Paditësi në ankesë i është referuar disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit.

Me datë 24 shkurt 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtrësë AKP-ja pohon se argumentet e saj lidhur me ankesën i ka parashtruar në mbrojtje në ankesë, andaj nuk do të përsëriten më ngase kjo nuk do të ishte e dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 03 shkurt 2023, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin AC-I-22-0012 e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së dhe të Autoritetit të Likuidimit, që paditësi nuk ka sjellë prova të mjaftueshme për ta aprovuar kërkesën e paditësit për pagat e pretenduara ndaj NSH-së. Pas kthimit të lëndës në rigjykim me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit AC-I-20-0061 të datës 02 shtator 2021, shkalla e I-rë me datë 15 shtator 2021, lëshon një Urdhër për paditësin dhe për AKP-në dhe kërkon nga të dy palët që të dorëzojnë të gjitha provat që deri më tani nuk janë dorëzuar në shkresat e lëndës lidhur me pretendimet e palës paditëse për paga për periudhën e cekur, duke paralajmëruar të dy palët që nëse nuk sjellin prova të reja do të vendos në bazë të provave që i ka në dispozicion në shkresat e lëndës. Me këtë urdhër shkalla e I-rë ju dha mundësi të dy palëve të sjellin prova të reja. AKP-ja në përgjigje të urdhrit pohoi se barra e provës në bazë të nenit 7 të LPK-së bie mbi paditësin, dhe është qëndrim i saktë i saj. Paditësi pohoi që provat që i kishte ai i ka dorëzuar në gjykatë, ndërsa provat tjera që nuk janë specifikuar duhet të kërkohen nga AKP-ja. Është e qartë se paditësi nuk e ka mbështetur mjaftueshëm me prova ankesën e paraqitur ndaj Vendimit të Autoritetit të

Likuidimit. Padiësi e ka sjellë Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe fotokopjen e Librezës së punës dhe këto dëshmi vërtetojnë që padiësit formalisht marrëdhënia e punës i është ndërprerë me datë 22 maj 2007, mirëpo këto prova nuk ishin të mjaftuara që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar. Padiësi pretendon se ka punuar në NSH deri në ditën e privatizimit, mirëpo nuk sjellë prova se për periudhën për të cilën ai i kërkon pagat ka ofruar shërbime pune për NSH-në. Listat e pagave të ofruara nga padiësi me ankesën në shkallën e dytë para se lënda të kthehej në rigjykim, siç ka konstatuar Kolegji i Apelit kanë pasur të meta pasi që nuk kanë qenë protokolluara dhe të vulosura nga NSH-ja për tu konsideruar si prova valide për gjykatën, dhe këtyre provave me të meta të tilla Kolegji i Apelit nuk u ka besuar. Andaj për këto arsye lënda ishte kthyer në rigjykim për ti dhënë rast padiësit të sjellë prova të reja që e mbështesin pohimin e tij se ai vërtet ka punuar në NSH për periudhën janar 2006-dhjetor 2007, dhe se ai ka të drejtë në pagat e pretenduara ndaj NSH-së. Padiësi siç u tha në procedurën e rigjykimit nuk ka sjellë prova tjera, madje këtë nuk e ka bërë as me ankesën në procedurën ankimore.

Me datë 21 shkurt 2023, padiësi për mes postës e dorëzon një parashtresë lidhur me korrigjimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-22-0012 të datës 03.02.2023. Në këtë parashtresë i autorizuari i padiësit pohon se pas marrjes së vendimit nga ana e Kolegjit, ka dorëzuar Letër pezullimin e datës 22 maj 2007, formularin e kërkesës, Librezën e punës, Listat e pagave të hartuara nga kontabilisti i Njësisë së Magjistralsë në Prizren, Deklaratën në Betim të noterizuar të dhënë nga Sh Sh dhe A K, kopjet e Letërnjoftimeve të noterizuara. Tutje ai pohon se kemi dorëzuar prova se Sh Sh dhe A K kanë qenë Drejtor dhe kontabilist, si Kontratat e punës. Në këtë parashtresë përfaqësuesi i padiësit pohon se Kolegji i Apelit në vendimin e tij nuk i ka përmendur fare provat e cekura, kur e ka refuzuar ankesën. Ai pohon se nuk është i sigurt nëse Deklarata e noterizuar është dorëzuar tek Kolegji i Apelit nga shkalla e I-rë. Tutje ai pohon se është e pakuptueshme mënyra se si ka vendosur Kolegji i Apelit, pasi që në tri raste tjera të punëtorëve tjerë të kësaj NSH-ja, me të njëjtat prova Kolegji i Apelit me përbërje të njëjtë i ka aprovuar ankesat e punëtorëve, duke u thirr në rastet

AC-I-21-0339, AC-I-15-0274 dhe AC-I-16-0001. I autorizuari i paditësit në këtë parashtresë pretendon se Kolegji i Apelit gjatë vlerësimit të provave të njëjta përdorë standarde të dyfishta, dhe është e qartë se nuk ka krijuar praktik të konsoliduar. Me këtë parashtresë i autorizuari i paditësit në bazë të arsyeve të cekura kërkon korrigjimin dhe plotësimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-22-0012 të datës 03.02.2023.

Me datë 07 prill 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në parashtresën e paditësit të datës 21 shkurt 2023. Në këtë parashtresë AKP-ja ka pohuar se Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është i bazuar në ligj dhe prova dhe si i tillë duhet të vërtetohet. Tutje AKP-ja pohon se pretendimet e veta dhe argumentet ligjore në mënyrë të mjaftueshme i ka qartësuar në mbrojtjen në padi dhe në procedurat e mëvonshme, andaj përsëritja e këtyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa i e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Parashtresa e parashtuar nga Ankuesi është e papranueshme.

Në bazë të Nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Kolegji i Apelit vëren se sipas Nenit 9, paragrafi 14 i Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë përfundimtare dhe nuk janë subjekt i ndonjë ankimi të serishëm. Përveç kësaj, as LDHP dhe Shtojca e vitit 2012(tashmë i shfuqizuar) po ashtu nuk parashihnin ndonjë mjet të jashtëzakonshëm kundër aktvendimeve apo aktgjykimeve të tilla të Kolegjit të Apelit (asnjë mjet i tillë i jashtëzakonshëm nuk

është paraprak as me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 dhe Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2008/6).

Kolegji i Apelit vëren se në lëndën konkrete, AC-I-22-0012 tashmë është vendosur nga Kolegji i Apelit me Aktgjykimin e datës 03 shkurt 2023, i cili është i plotfuqishëm. Andaj, parashtresa e Ankuesit e datës 21 shkurt 2023 e parashtruar kundër Aktgjykimit të plotfuqishëm të Kolegjit të Apelit, si është vendosur tani më nga jurisprudenca e tij(ASC-09-0106, AC-I-13-0088, AC-I-13-0128, AC-I-16-0253 etj), është e papranueshme dhe si e tillë hedhet poshtë.

Kolegji i Apelit vëren se Ankuesi me këtë parashtresë kërkon "korrigjim" dhe "plotësim" të Aktgjykimit të plotë fuqishëm të Kolegjit të Apelit, gjë që në bazë të nenit 9.14 të LDHP-së, në këtë fazë të procedurës nuk është më e mundur. Andaj Kolegji i Apelit nuk është marrë me meritat e kërkesës për korrigjim dhe plotësim të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Kolegjit të Apelit.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë, ndërsa lidhur me këtë parashtresë Kolegji i Apelit nuk e ngarkon paditësin të paguaj taksë gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
